

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

PËR

BASHKËPUNIM NË FUSHËN E INFORMIMIT DHE PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË VENDIMMARRJEN MJEDISORE

A. QËLLIMI

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), Milieukontakt Shqipëri (MiA) dhe Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) për efekt të këtij memorandumi, të quajtura Palë, nëpërmjet këtij memorandumi institucionalizojnë bashkëpunimin në fushën e informimit dhe tërheqjes së mendimit të publikut në vendimmarrjen mjedisore.

B. TË PËRGJITHSHME

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, që është një institucion qendror publik në varësi të Ministrisë së Mjedisit, ndër objektivat e saj në fushën e monitorimit të mjedisit gjithashtu kryen:

- funksione rregullatore për lejet e mjedisit në përputhje me dispozitat e legjislativës;
- krijon dhe menaxhon sistemin e informacionit mjedisor;
- siguron informacion mjedisor për publikun në lidhje me çështjet mjedisore.

Organizatave kanë si mision të kontribuojnë në një zhvillim të qëndrueshëm dhe mjedis të shëndetshëm nëpërmjet ofrimit të shërbimeve në partneritet me aktorët e interesuar. Projekti “Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm” që ato po zbatojnë, ka për qëllim të

kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore përmes përmirësimit të kuadrit rregullator dhe të nxisë më shumë pjesëmarrje dhe transparencë në proceset e vendimmarrjes mjedisore (VNM dhe VSM) dhe për të rritur vëmendjen e medias në këtë fushë, me përfitime për shoqërinë në përgjithësi.

Palët, i) *duke e konsideruar informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, si një çështje të rëndësishme që duhet përmirësuar*, ii) *të ndërgjegjshëm* për rolin që kanë në nxitjen e demokracisë në vendimmarrjen mjedisore, iii) *të bindur* se mbrojtja e mjedisit realizohet nëpërmjet një vendimmarrje gjithëpërfshirëse të dakortësuar me të gjithët palët, angazhohen që nëpërmjet bashkëpunimit të kontribuojnë për një mjedis të shëndetshëm, në një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe në një angazhim gjithëpërfshirës të shoqërisë civile.

C. FUSHA KRYESORE E BASHKËPUNIMIT

Palët marrin masat e nevojshme për të përmirësuar procesin e informimit dhe konsultimit me publikun, veçanërisht nëpërmjet veprimtarive të mëposhtme:

1. procesin e vlerësimit të VNM të organizuara nga AKM për projekte me ndikim mjedisor;
2. proceset e konsultimit me publikun në diskutimet e VNM të organizuara nga AKM/ARM;
3. Palët organizojnë aktivitete të përbashkëta si takime dhe/ose tryeza pune, me pjesëmarrjen e specialistëve të të dyja Palëve, për përmirësimin e procesit; Palët publikojnë dhe/ose shkëmbejnë zyrtarisht të dhëna dhe informacione, për përmirësime në legjislacionin dhe vendimmarrjen në Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM).

D. KOORDINIMI I BASHKËPUNIMIT

Në funksion të këtij memorandumi caktohet specialisti i AKMsë, për të koordinuar veprimtaritë me palët, për të monitoruar zbatimin e objektivave të këtij memorandumi.

E. AFATI I MEMORANDUMIT DHE AMENDIMET

Ky Memorandum do të zbatohet për një periudhë 2 vjeçare. Me miratimin e palëve, memorandumit mund t'i bëhen amendime të ndryshme.

Nënshkruar nga përfaqësuesit e palëve në dy kopje, në Tiranë, në datën e poshtë shënuar.

F. KOORDINIMI DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT

AKM/ARM do të informojë palët mbi organizimin e dëgjësave publike në keto adresa:

info@inca-al.org

office@milieukontakt.org

eden@eden-al.org

Tiranë më 15.02.2017

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

Emri Mbiemri

Ilirjan Begjiri

Firma




Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

Emri Mbiemri

Arif Dreqoti

Firma

Milut



Milieukontakt Shqipëri (MiA)

Emri Mbiemri

Viktorina Metreva

Firma

[Signature]



Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)

Emri Mbiemri

Lisa Hekuri

Firma

Lisa Hekuri

